

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 8, neni 20 paragrafi 1 alineja 11, në lidhje me nenin 91 paragrafi 4 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14) dhe nenit 15 paragrafi 1 alineja 7 dhe neni 39 paragrafi 1 alineja 3 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nr. 01-4351/1 nga data 29.08.2014, në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr. 02-5903/4 nga data 04.12.2014, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, në mbledhjen e 20-të, të mbajtur më 04.12.2014, miratoi

## **RREGULLORE PËR EMETIMIN E VEPRAVE EVROPIANE AUDIOVIZUELE DHE VEPRAVE NGA PRODUCENTË TË PAVARUR**

### Neni 1

#### **Lënda e Rregullores**

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra se si radiodifuzerët që kryejnë veprimtari në nivel shtetëror në shërbimet e tyre programore televizive do të sigurojnë përfaqësim të veprave evropiane audiovizuale dhe veprave nga producentë të pavarur.

Kjo Rregullore nuk ka të bëjë me obligimin e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë që ta promovojnë prodhimtarinë dhe qasjen deri te veprat evropiane audiovizuale, nga neni 60 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

### Neni 2

#### **Definicionet**

Shprehje të caktuara, që janë përdorur në këtë Rregullore e kanë këtë domethënie:

**Vepra Evropiane audiovizuale** janë veprat që janë definuar në nenin 3 paragrafi 1 pika 9 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, e që rrjedhin nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, nga shtete të treta evropiane, nënshkruese të Konventës për televizion tejkufitar pranë Këshillit të Evropës ose janë të prodhuara në kuadër të marrëveshjeve që kanë të bëjnë me sektorin audiovizuel, të lidhura ndërmjet BE-së dhe vendeve të treta;

**Vepra audiovizuale të Maqedonisë** janë veprat e prodhuara burimore nga shtetas të Republikës së Maqedonisë në gjuhën maqedonase ose në gjuhët e bashkësive etnike që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, si dhe veprat e trashëgimisë kulturore të Republikës së Maqedonisë;

**Vepra të trashëgimisë kulturore audiovizuale të RM-së** janë pasuritë audiovizuale dhe fonoteke që paraqesin trashëgimi kulturore të RM-së dhe që janë të dedikuara për paraqitje publike.

**Vepra audiovizuale të prodhimit personal** janë vepra të krijuara me iniciativë dhe në organizim të vetë radiodifuzerit, vepra të porositura nga radiodifuzeri (prodhim i porositur) ose të prodhuara në koproduksion.

**Producent i pavarur** është personi fizik ose juridik që ofron prodhimin e veprave audio ose audiovizuale, me kusht që:

- të mos ketë pjesëmarrje në kapitalin e radiodifuzerit me më shumë se 25% dhe

- radiodifuzeri të mos ketë pjesëmarrje në kapitalin e producentit.

### Neni 3

#### **Për cilat servise nuk vlen obligimi**

Obligimi që të sigurohet përfaqësimi i veprave evropiane audiovizuele dhe veprave nga producentë të pavarur, nuk ka të bëjë me:

- Shërbimet programore televizive të përkushtuara vetëm për lajme, ngjarje sportive, loja, reklamime, teleshopingut dhe shërbimeve të teletekstit;
- Shërbimi programor televiziv i RTM në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që është i ndryshëm nga gjuha maqedonase dhe të bashkësive tjera jo shumicë;
- servisi i RTM i dedikuar për emetimin e aktiviteteve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë; dhe
- Shërbimet programore televizive të RTM përmes satelitit, të dedikuara për mërgimtarët dhe qytetarët e Republikës së Maqedonisë që jetojnë në Evropë dhe në kontinentet tjera.

### Neni 4

#### **Çka nuk konsiderohet si vepër evropiane audiovizuele**

Në vepra evropiane audiovizuele hyjnë të gjitha llojet e programeve të emetuara nga radiodifuzeri, përveç lajmeve ose ditarëve televizive; ngjarjeve sportive; lojërave; emetimeve ose incizimeve të seancave të organeve të pushtetit; emetimet ose

Incizimet e ngjarjeve shoqërore-politike; info-servisit; programeve me horoskop, tarot, parashikues ose interpretim të ëndrrave; spoteve muzikore; dhe përmbajtjeve që nuk i nënshtrohen klasifikimit të përcaktuar në pikën 17 të Udhëzimit për mënyrën e

Klasifikimit të llojeve të programeve audio dhe audiovizuele<sup>1</sup> (komunikimet komerciale audiovizuele; publikimet e radiodifuzerit në lidhje me programet e tija personale; deklarata me interes publik; apele për qëllime humanitare; intermexo; programe fetare, shërbesa dhe predikime; programe për kulturë fizike dhe rekreacion; dhe shpicat për hapje dhe mbyllje, xhingla dhe avizo).

### Neni 5

#### **Mënyra e përlllogaritjes së përfaqësimit të veprave evropiane audiovizuele**

Përqindja e veprave evropiane audiovizuele llogaritet nga koha e përgjithshme që gjatë vitit është ndarë për emetim të llojeve të programeve që nuk janë të përfshira në nenin 4 të kësaj Rregullore.

Në përqindjen për vepra evropiane audiovizuele llogariten vetëm dy emetime të çdo vepre (premiera dhe repriza e parë) gjatë një viti, pa marrë parasysh vitin e prodhimit.

Në vepra evropiane audiovizuele bëjnë pjesë edhe veprat audiovizuele të prodhimit personal të radiodifuzerit dhe veprave audiovizuele të Maqedonisë.

---

<sup>1</sup> Udhëzimi për mënyrën e klasifikimit të llojeve të programeve audio dhe audiovizuele, në të cilën referohet neni 4 i kësaj Rregullore, është publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 171/14

#### Neni 6

### **Plotësimi progresiv i obligimit për vepra evropiane audiovizuele**

Shërbimet programore televizive që për herë të parë do të marrin leje për emetim televiziv në nivel shtetëror pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, obligimin për përfaqësimin e veprave evropiane audiovizuele e plotësojnë në mënyrë progresive, në periudhë prej 5 viteve, ashtu që:

- vitin e parë përqindja e përfaqësimit të veprave evropiane audiovizuele duhet të jetë së paku 10%, kurse
- në vitin e dytë, tretë dhe e katërt, përqindja e përfaqësimit të veprave evropiane audiovizuele duhet të rritet së paku nga 10% në vit, kurse në vitin e pestë duhet të jetë së paku 51%.

#### Neni 7

### **Obligimi për vepra nga producentë të pavarur**

Radiodifuzerët që emetojnë shërbime të programit televiziv në nivel shtetëror janë të obliguar që nga buxheti vjetor i dedikuar për programe (dhe për prodhim dhe për blerje të programit televiziv), të ndajnë së paku 10% për vepra evropiane audiovizuele të prodhuara nga producentë të pavarur, me ç'rast së paku gjysma e tyre duhet të jenë të prodhuara në pesë (5) vitet e fundit.

#### Neni 8

### **Obligimi për evidentimin dhe sigurimin e të dhënave**

Radiodifuzerët që emetojnë shërbime të programit televiziv në nivel shtetëror janë të obliguar që të mbajnë evidencë ditore për emetimin e veprave të emetuara evropiane audiovizuele dhe veprave të prodhuara nga producentë të pavarur gjatë vitit dhe më së voni deri më 31 mars vitin e ardhshëm, ta njoftojnë Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele për plotësimin e këtyre obligimeve gjatë vitit të kaluar kalendarik.

Të dhënat i plotësojnë në Formular për vepra evropiane audiovizuele dhe vepra nga producentë të pavarur të përcaktuar nga Agjencia. Renditja e vendeve, veprat audiovizuele e të cilave sipas kushtit gjeografik kualifikohen si evropiane është pjesë përbërëse e Formularit.

Bashkë me njoftimin, radiodifuzerët mund ti dorëzojnë Agjencisë edhe cfardo qoftë të dhëna tjera kualitative për përpjekjet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë prodhimit, porositjes, blerjes dhe emetimit të veprave evropiane audiovizuele dhe veprave nga producentë të pavarur, si dhe për cfardo inicitative që e kanë ndërmarrë ose planifikojnë që ta ndërmarrin për të plotësuar qëllimet e Ligjit.

#### Neni 9

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore pushon vlefshmëria e Rregullores për vepra evropiane audiovizuele ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 133/2006).

Neni 10

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e ardhshme pas ditës së publikimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë"

**Agjencia për shërbime  
mediatike audio dhe audiovizuale**

**Kryetar i Këshillit**

**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

Nr. 01-5977/1  
04.12.2014  
Shkup